



14 -10- 2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 2694-2021



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 9, dhe 12 të Rregullës Zgjedhore 18/2016 për Emërimin, Përbërjen dhe Funkionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.10.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së për Autorizimin e KKZ-ve për Vendim-Marrjen e Zëvendësimeve të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Miratohet rekomandimi i Sekretariatit të KQZ-së për autorizimin e KKZ-ve për vendim-marrjen e zëvendësimeve të KVV-ve për zgjedhjet lokale 2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Data / Datum	13.10.2021
Për / Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Nga / Od	Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren
Përmes/Preko	Këshillit për Operacione Zgjedhore Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së
Kopje / Kopija	Arkivës / Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve
Lënda / Predmet	Rekomandim për autorizimin e KKZ-ve për vendim-marrjen e zëvendësimeve të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale 2021

Të nderuar Anëtar

Duke u bazuar në vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr.protokolli 44-2021 të datës 02.06.2021 për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, të pranuar në KQZ-së me Nr.protokolli 1645-2021, datë 15.06.2019, vendimit të KQZ-së Nr.1661-2021 të datë 18.06.2021 për miratimin e Planit Operacional për Zgjedhjet Lokale 2021 në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të obligimeve kushtetuese që ka KQZ, respektivisht Sekretariati i KQZ-së, për funksionalizimin, menaxhimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në mënyrë profesionale, efikase, të pavarur dhe mirë të administruar. Departamenti i Koordinimit në Terren, si njësi organizative në kuadër të Sekretariatit të KQZ-së, kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të miraton kërkesën tonë emergjente me arsyeshmërinë e saj.

Ndaj, në bazë të paragrafit 1, 9 të nenit 9, paragrafit 5 të nenit 12 të Rregullës Zgjedhore 18/2016 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, kërkojmë nga KQZ, të autorizon Komisionet Komunale të Zgjedhjeve që çdo kërkesë e cila paraqitet nga Subjektet Politike për Zëvendësimin e Anëtareve të KVV-ve për Zgjedhjet Lokale 2021 që deri të **premtën me datë 15.10.2021 në ora 16:00 të kenë të drejtë vendim-marrje** për secilin zëvendësim të personalizuar, i cili vendim **DUHET** të merret me konsensus apo me shumicë të thjeshtë nga KKZ, dhe secili KKZ obligohet t'i dërgon vendimet e tyre, deri një ditë para ditës së zgjedhjeve në ora 12:00 në DKT, me qellim të pajisjes me bexha dhe pagesave të tyre.

Arsyetim

Përgjatë, zhvillimit të seancave të trajnimit të KVV-ve kemi shumë tërheqje nga anëtarët e KVV-ve dhe kërkesa të vazhdueshme nga subjektet politike për zëvendësimin e anëtarëve të KVV-ve, dhe me qellim të përfaqësimit të tyre në secilin vendvotim, është i domosdoshëm autorizimi për KKZ-të lidhur me vendim-marrjen për zëvendësimin e KVV-ve për Zgjedhjet Lokale 2021 (përfshirë raundin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve).

Me respekt,